



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0866

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE) “CONSTRUMAX SH.P.K.” kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i therrtores publike” me numër të prokurimit “616-23-7338-5-1-1”, me 05/12/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “CONSTRUMAX SH.P.K.” me nr. 2024/0866, e datës 18/09/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i therrtores publike” me numër të prokurimit “616-23-7338-5-1-1”

2. Mbetet në fuqi, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i therrtores publike” me nr. të prokurimit: “616-23-7338-5-1-1”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 18.07.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i therrtores

publike” me numër të prokurimit 616-23-7338-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar 3,500,000.00€.

Me datë 23.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë “Alfa I ShPK”.

Me datë 28.08.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 09.09.2024.

Me datë 18.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0866.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues manifestohen duke kundërshtuar arsyet për eliminimin e parashtruesit nga ky aktivitet i prokurimit sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të bashkangjitur me B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 23.08.2024. Më konkretisht parashtruesi pretendon se i përmbush të gjitha kërkesat e DT duke përfshirë edhe autorizimin për min. 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas kërkesës nr. 6 të DT lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit. Po ashtu pretendon se ka dorëzuar me rregull edhe planin dinamik si dhe ka përmbushur specifikat teknik lidhur me dyert e frigodhomave, dritaret, VRF, gypat për ujësjellës, njësitë për friza për të cilat është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Njëkohësisht parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për arsye se nuk ka sigurim të validitetit nga data 23.02.2024 deri me 23.07.2023, pastaj nuk e plotëson kërkesën për trupin ndriçues sipas pozicionit 26.5 të paramasës sepse në trupi e ka mbrojtjen vetëm IP65 dhe jo IP66, pastaj nuk ka prezantuar çertifiaktat, katalogjet, test raportet apo dokumentet tjera lidhur me poz. 11.1 deri 11.7, poz. 13.1, poz. 16.10 dhe 16.12, poz. 23.1 deri 23.4 dhe poz. 26.5. Lidhur me tenderuesin e rekomanduar, parashtruesi pretendon po ashtu se i njëjti nuk ka dorëzuar planin dinamik me rregull pasi që aty ka prezantuar përshkrime të pashpjegueshme dhe mangësi në evidentimin e pozicioneve, si dhe pretendon që tenderuesi i rekomanduar nuk ka prezantuar dokumentet e kërkuara lidhur me pajisjet 4 kamion 20-30 ton, pastaj mungon një test raport, pastaj nuk ka prezantuar licensë VNM si dhe deklarata nën betim nuk është në formatin e duhur. Parashtruesi ka paraqitur pretendime ankimore edhe kundër tenderuesve të tjerë të eliminuar si të papërgjegjshëm sikurse GOE “Arcumstudio & Muhamet Muçiçi & VIA egnatia shpk” si dhe GOE “Limitproject & Delta & Rinesa & Ilea-gr” pavarësisht që të njëjtit tanimë janë eliminuar si

të papërgjegjshëm.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 14.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues:

Lidhur me pretendimet ankimore me të cilat janë kundërshtuar arsyet eliminuese, eksperti shqyrtues ka konstatuar se *“AK-Komuna e Prishtines ne Letrën Standarde per tenderuesin e eliminuar nuk i referohet ndonjë pozicioni te caktuar se për te cilët është ofruar katalogu i një prodhuesi tjetër ndërsa autorizimi nga prodhuesi tjetër. Edhe vetë Autoriteti Kontraktues përmes letres standarde per tenderuesin e eliminuar thekson se nuk sqarimet e ofruara me datë 14.08.2024 nga OE Construmax nuk janë bindëse sipas DT- se, njoftimit për kontrate, dhe ofertës se dorëzuar nga OE-ik.’ Pra AK përdorë terme qe nuk janë te parapara me Ligjin për Prokurim. Kërkesat e përzgjedhjes janë kërkesa te formës kalon/nuk kalon dhe vlerësimet e tilla qe nuk janë "bindëse" nuk janë në harmoni te plotë me dizpozitat ligjore te LPP-së. Bazuar ne përshkrimin e bërë me lartë, sqarimet shtesë te kërkuara nga AK-KK Prishtinë dhe ofrimit te sqarimeve shtesë nga OE ankues sqarojmë se pika 1 e pretendimit ankimor 4 është e bazuar. AK-Komuna e Prishtines ne lidhje me ketë kërkesë ka kërkuar po ashtu sqartime shtesë përmes letrës standarde per sqarime shtesë te datës 12.08.2024. OE ankues pretendon se ne shkresën e dytë sipas kërkesës per sqarime ka dorëzuar certifikatat e kërkuara. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues Construmax përmes E –prokurimit ne shkresën me emërtim “Shkresa 2 - Sqarimet nga Construmax lidhur me Letrën standarde për sqarime shtesë të dt 12.08.2024.pdf dt. 14.08.2024 13:22, ka dorezuar çertifikatat si në vijim: ISO 9001:2015; ISO 14001:2015; ISO 45001:2018; ISO 22000:2015. Te gjitha këto certifikata te dorëzuar me datë 14.08.2024 nga OE ankues kanë validitet ne kohen e dorëzimit te tyre. Ndërsa sa i përket përdorimit te gjuhëve ne dokumentet e tenderit mendojmë se AK duhet te veproje ne harmoni te plotë me opinionin e KRPP-së te datës 22.06.2023 Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së? “Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohe nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument”. Bazuar ne përshkrimin e bërë me lartë, sqarimet shtesë te kërkuara nga AK-KK Prishtinë dhe ofrimit te sqarimeve shtesë nga OE ankues përmes Shkresa 2 - Sqarimet nga Construmax lidhur me Letrën standarde për sqarime shtesë të dt 12.08.2024.pdf dt*

. 14.08.2024 13:22 sqarojmë se pika 3 dhe 4 e pretendimit ankimor 4 është e bazuar ne lidhje me validitetin e ISO Standardeve , ndërsa sa i përket çështjes se dorëzimit te ISO ne gjuhen polake te veprohet sipas opinionit te larcekur te KRPP dt. 22.06.2023. Bazuar ne sqarimet e ofruara nga OE Construmax me datë 14.08.2024 te gjitha ISO standardet kanë validitet te ofertave.

Bazuar ne përshkrimin e mesiperm, sqarimeve shtesë te ofruara nga OE Construmax me datë 14.08.2024 pretendimi ankimor 4 është pjesërisht i bazuar. AK gjatë rivlerësimit te ofertave te vërteton nëse ka dyshime përmes sqarimeve shtesë va liditetin e ISO standardeve dhe paqartësive tjera ne harmoni me nenin 72 te LPP dhe 38 te Rr. PP. Sqarojmë se ky pretendim ankimor ne lidhje me planin dinamik është trajtuar edhe nga eksperti shqyrtues ne raportin nr 2024/0001 dhe si rrjedhoj e kësaj edhe ne ndajm te njëjtin mendim sa i përket trajtimit te planit dinamik. Shtojmë se AK-KK Prishtinë nëse do te kishte paqartësi ne lidhje me planin dinamik mund te kërkoj edhe sqarimet shtesë sipas nenit 72 te LPP-se dhe nenit 38 te Rr.PP. Bazuar ne përshkrimin e bërë me lartë, përshkrimit te bërë tek pretenidmi ankimor nr 3 ne raportin 2024/0001, planit dinamik te dorëzuar nga OE ankues, kërkesës ne dosje te tenderit ne lidhje me planin dinamik kostatojmë se pretendimi ankimor nr. 5 është i bazuar”.

Lidhur me pretendimet e parashtruesi drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar, eksperti shqyrtues ka gjetur si vijon:

“lidhur me validitetin e ofertës - Ne këtë rast nuk kemi kontinuitet te validitetit te ofertave si rezultat e mos kërkesës nga ana e AK me kohë per zgjatje te vakuditetit te ofertave. Pasi qe interpretimi i mësipërm është i përgjithshëm dhe nuk i referohet gjendjes konkrete te nje aktivitetit te prokurimit dhe bazuar ne faktin se shkelja ka ndodhur si rezultat i “n eglizhencave” nga AK rekomandojmë qe ne procedurën e rivlerësimit AK te marrë nje interpretim per rastin konkret nga KRPP si te veprohet ne këto raste me ofertat përkatëse si rezultat i veprimeve apo mos veprimeve te përshkruara me lartë. Bazuar ne përshkrimin e bërë me lartë , sipas nenit 30 te RrPP dhe gjendjes aktuale ne lidhje me validitetin e ofertave mendojmë se ky nen pretendim ankimor (Gjetja e parë) është pjesërisht i bazuar.

***Lidhur me çertifikatat iso/test raportet -** Sqarojmë se ne lidhje me nen pretendimin nr 1 tek e gjetura nr. 3 ne dosje te tenderit askund nuk rezulton se AK-KK Prishtinë ka kërkuar çertifikat ISO 10002:2018. OE ankues pretendon se katalogu i dorëzuar per këto pozicione nuk i plotëson specifikat e kërkuara per këto pozicione mirëpo pa saktësuar se cilat specifika këto pozicione nuk i plotesojn ne raport me kërkesne e dosjes se tenderit. Sqarojmë se ky nen pretendim ankimor 3 tek e gjetura nr 3 është i pa bazuar sepse ne këtë rast kemi te bëjmë me standard te njëjtë mirëpo vetëm ndryshon versioni i standardit. Bazur ne përshkrimin e bërë me sipër sqarojmë se e gjetura nr. 3 është e pa bazuar.*

***Lidhur me planin dinamik -** Sqarojmë se tek pretendimi ankimor i emërtuar si e gjetura nr 4 nga OE ankues kemi të bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht te bazuar sepse plani dinamik ne raste*

tilla duhet te jetë i detajuar ne menyre qe te jetë e saktë koha e ekzekutimit dhe implementimit te gjitha pozicioneve te caktuara dhe sidomos ne ketë rast ku afati i implementimit është edhe nen kriter për dhënie kontrate dhe i poentuar me 20 pikë.

Lidhur me pajisjet - Sqarojmë se tek follderi 7 kamion kiper 20-30T gjenden 4 libreta te kamionëve kiper me dy dyer.

Andaj pretendimi ankimor i emërtuar si e gjetura nr. 6 nga OE ankues është i pa bazuar.

Andaj pretendimi ankimor i emërtuar si e gjetura nr. 7 nga OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me stafin - Sqarojmë se pretendimi ankimor i emërtuar si e gjetura nr. 9 nga OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me deklaratën nën betim - Sqarojmë se pretendimi ankimor i emërtuar si e gjetura nr.10 nga OE ankues është i pa bazuar sepse OE Alfa I, ka dorëzuar deklaratën nen betim sipas formës standarde te Aneks 2 te dosjes se tenderit”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat

dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues ka gjetur se pajtohet me ekspertin shqyrtues se pretendimet ankimore lidhur me deklaratëm nën betim, çertifikatat ISO dhe për pajisjet janë pretendime të pabazuara pasi që tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare ashtu siç janë kërkuar me DT lidhur me këto pika. Paneli Shqyrtues nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues se pretendimet ankimore lidhur me validitetin, planin dinamik dhe inxhinierin janë vetëm pjesërisht të bazuara pasi që paneli ka gjetur se edhe këto pretendime janë të pabazuara në tërësi. Sa i përket validitetit të ofertës, Paneli potencon faktin që është detyrim i AK që të kërkoj vazhdimin e validitetit të ofertës dhe OE nuk mund të mbaj përgjegjësi në rastet kur AK nuk e kërkon vazhdimin e validitetit. Në rastin konkret tenderuesi i rekomanduar e ka konfirmuar vazhdimin e validitetit sipas kërkesës së AK dhe nuk mund të konstatohet që i njëjti nuk ka pasur validitet sikurse pretendon parashtruesi. Prandaj pretendimi në këtë pikë është i pabazuar. Sa i përket pretendimit për planin dinamik dhe për stafin, tenderuesi i rekomanduar i ka dorëzuar dëshmitë dokumentare që janë kërkuar sipas DT dhe AK nuk mund të kërkoj të dorëzohen dokumente që nuk janë përcaktuar me DT as përmes sqarimeve shtesë sikurse konstaton eksperti shqyrtues. Plani dinamik është dorëzuar po ashtu sipas dosjes së tenderit. Prandaj edhe këto pretendime ankimore si të tilla janë të pabazuara. Sa i përket karakteristikave të trupit një trupi ndriçues i cili ka mbrojtje IP65 dhe jo IP66 sipas specifikave teknike, Paneli Shqyrtues sqaron se në këtë rast kjo e gjetur jo vetëm që është devijim i vogël në kuptim të nenit 45.19 të RRPP, por është aq jorelevant sa që në asnjë formë nuk mund të ndikoj në aspektet materiale as të ofertës as të DT por as në qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Në këtë formë Paneli Shqyrtues ka gjetur se oferta e tenderuesit të rekomanduar është e përgjegjshme dhe i plotëson kërkesat e përcaktuara nga vet AK përmes dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë të eliminuar, këto pretendime janë trajtuar edhe në vendimet paraprake të OSHP lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është kontestues fakti që të njëjtit kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme dhe si të tillë janë eliminuar nga autoriteti kontraktues.

Lidhur me pretendimet ankimore të drejtuara kundër arsyeve eliminuese të evidentuara nga AK në letrën standarde për parashtruesin si tenderues të eliminuar për shkak të ofertës së papërgjegjshme, Paneli Shqyrtues ka gjetur se eksperti shqyrtues nuk ka marrë fare parasysh sqarimet e AK të elaboruara në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit – OE ankues. Sidoqoftë, duhet theksuar faktin që oferta e parashtruesit është rreth 11% apo 354,545.45 euro më shtrenjtë sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Më konkretisht tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 2,877,777.78 euro ndërsa parashtruesi ka ofertuar me çmim prej 3,232,323.23 euro përkatësisht me çmim rreth 11% apo 354,545.45 euro më shtrenjtë. Prandaj cilido epilog i rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit nuk do të manifestonte parashtruesin si palë të interesuar përderisa oferta e tenderuesit të

rekomanduar është e përgjegjshme ndërsa oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Pavarësisht që Paneli Shqyrtues konsideron se cilido rezultat i pretendimeve ankimore kundër arsyeve eliminuese nuk është relevant për ndryshimin e epilogut përfundimtar të aktivitetit të prokurimit, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin sqarimeve të ofruara nga autoriteti kontraktues të elaboruara në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit ku ndër të tjera është potencuar se *“Për pozicionet 29.11 dhe 30.1 ju keni dorëzuar një katalog nga kompania kineze Haier Comercial Air Conditioning mirëpo nuk keni bashkangjitur fare autorizim të prodhuesit. Rrjedhimisht për këto dy pozicione nuk keni përmbushur kërkesën nr. 4 dhe 5 të kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit. Në anën tjetër për pozicionet 29.11 dhe 30.1 ju keni dorëzuar një garancion të prodhuesit nga një kompani tjetër që është Engoffice. Përndryshe në këtë garancion nuk potencohet se ofrohet garancioni për 1 vit për pozicionet 29.11 dhe 30.1 por përmenden 4 pajisje të tjera me përshkrime të cilat nuk përkojnë me pozicionet përkatëse. Përndryshe, jo vetëm që mungon autorizimi i prodhuesit dhe katalogu nuk përputhet me garancion, por i njëjti nuk përputhet as me vet pozicionet përkatëse. P.sh në katalog askund nuk është arritur që gjendet rekupatori me përshkrimin si në poz. 29.11, etj. Pra ju nuk keni arritur që të përmbushni këtë kërkesë të dosjes së tenderit prandaj në këtë pikë keni dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën edhe jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit”*. **Sa i përket dorëzimit të dokumenteve në gjuhë jozyrtare**, Paneli Shqyrtues konsideron se eksperti shqyrtues para se të propozoj që të kërkohen interpretime nga KRPP është dashur që t'i referohet nenit 13 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”*. Në anën tjetër nuk është kontestues as për parashtruesin por as për ekspertin shqyrtues që disa nga dokumentet në ofertën e parashtruesit janë dorëzuar në gjuhë polake.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli konsideron se tani në këtë fazë të përmbylljes së aktivitetit të prokurimit, pretendimet ankimore janë jo relevante, përderisa i njëjti nuk ka arritur ta dëshmojë statusin e një OE të përgjegjshëm sikurse kërkohet me nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të LPP. Në kontekstin e kësaj dispozite, Paneli detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi I ofruar nga OE i cili është rekomanduar për kontratë është për 354,545.45 €, më I lirë, e që ky fakt nuk ka mundur të mohohet as nga AK. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet vetëm si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i therrtores publike” me numër të prokurimit 616-23-7338-5-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues njëkohësisht ka marrë parasysh edhe faktin se dallimi në çmim është rreth 400,000.00 euro më i lirë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - CONSTRUMAX SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: